



THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM
PROJEKTI EMERGJENT PËR
MASAT E EFIÇIENÇËS SË ENERGJISË
NË NDËRTESAY SHUMË-BANESORE (SOCIALE)
NË PRONËSI TË KOMUNAVE

1. Hyrje

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (“FKEE”) ka kënaqësinë ta shpallë këtë Thirrje Publike për zbatimin e një Projekti Emergjent që synon përmirësimin e kursimit të energjisë dhe rritjen e mirëqenies në ndërtesat shumë-banesore sociale në pronësi të komunave në Kosovë. Ky projekt mbështetet nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit të IPA-s - Pakos së Mbështetjes për Energji, të aranzhuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. FKEE-ja i fton të gjitha komunat e interesuara që t’i dorëzojnë aplikacionet e tyre për Projektin Emergjent të FKEE-së, i cili përfshinë (i) Grant për të investuar në masat e eficiencës së energjisë që do t’i rrisin kursimet e energjisë dhe (ii) përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve në ndërtesat shumë-banesore sociale, kryesisht grupet sociale të pa-favorizuara dhe të cenueshme (në tekstin e mëtejme “NShB-të sociale”).

Projekti Emergjent financohet nga Bashkimi Evropian, zbatohet nga FKEE dhe do të bashkë financohet nga Komuna e përzgjedhur. Detajet mbi nivelin e bashkëfinancimit janë elaboruar më tej në seksionin 3 të këtij dokumenti.

2. Kriteret e përzgjedhjes së përshtatshmërisë

Aplikuesi (komuna përkatëse) duhet t’i propozojë NShB-të sociale që i plotësojnë kriteret e mëposhtme të përshtatshmërisë si dhe disponueshmërinë e buxhetit të Aplikuesit për ta bashkë financuar këtë projekt:

- Ndërtesa e propozuar duhet të jetë në pronësi të komunës përkatëse;
- Ndërtesa e propozuar duhet të jetë e banueshme;
- Ndërtesa e propozuar duhet të jetë e banuar nga familjet përkatëse (vërtetohet me faturën e energjisë elektrike/numri i njehsorit)
- Ndërtesa e propozuar duhet të jetë e qëndrueshme dhe pa defekte në aspektin e strukturës dhe nuk i është nënshtruar ndonjë rinovimi të plotë për eficiencë të energjisë në pesë (5) vitet e fundit;
- Ndërtesa e propozuar aktualisht nuk është pjesë e ndonjë plani të transformimit, mbylljes, ri destinimit apo privatizimit;

- Linjë buxhetore specifike në dispozicion/zotimi i Aplikuesit për pjesëmarrje/bashkëfinancim.
- Zotimi i Aplikuesit për ta siguruar qëndrueshmërinë dhe mirëmbajtjen e investimeve në MEE në NShB-të sociale të përzgjedhura pas periudhës së 'Përgjegjësisë ndaj Defekteve' siç përcaktohet në secilën kontratë të punimeve.

3. Niveli i bashkëfinancimit nga FKEE-ja dhe Komuna

FKEE-ja do t'i sigurojë 90% të financimit si grant (pa kthim), ndërsa Komuna ofron 10% të financimit (pjesa e bashkëfinancimit). Prandaj, si pjesë e pakos së dokumenteve për aplikim duhet të përfshihet edhe zotimi me shkrim i Komunës për ta siguruar buxhetin që duhet t'i mbulojë 10% të investimeve në tërësi.

Pasi FKEE-ja t'i shqyrtojë dokumentet e ofruara përmes formularit të aplikimit në bazë të parimit "*kush vjen i pari, shërbehet i pari*" dhe të konfirmojë se aplikacioni i plotëson kriteret e lartpërmendura të përshtatshmërisë, Komuna e përzgjedhur do të ftohet që ta nënshkruajë një Marrëveshje për Projektin ("MP") me FKEE-në. Pas nënshkrimit të MP-së, e cila përfaqëson ligjërisht zotimin e Komunës për të bashkë financuar dhe zbatuar projektin, sipas rregullave dhe procedurave të FKEE-së, FKEE do të organizojë shërbime për kryerjen e auditimit të energjisë, zhvillimin e projekteve të detajuara dhe kushteve (termat) për kontraktimin e punimeve të ndërtimit për NShB-të e zgjedhura sociale.

Pas përfundimit të auditimit të energjisë dhe dizajnit të detajuar të NShB-ve sociale të përzgjedhura, FKEE do të nisë procedurat e prokurimit për angazhimin e kompanive të kualifikuara të ndërtimit për të zbatuar masat e efijencës së energjisë ("EE") në NShB-të e zgjedhura sociale në marrëveshje paraprake me Komunën. Shuma përfundimtare e financimit të përbashkët për këtë projekt do të përcaktohet pas dhënies së kontratës/angazhimit të kompanisë ndërtimore. Pas kësaj faze të procesit, FKEE dhe Komuna do të nënshkruajnë një Marrëveshje Bashkëfinancimi e cila do të përcaktojë nivelin e saktë të pjesëmarrjes në bashkëfinancim për zbatimin e masave të efijencës së energjisë të NShB-ve sociale të përzgjedhura. Marrëveshja e Bashkëfinancimit do të përfshijë 'Paramasën' e kontraktuar dhe detaje tjera të nga Marrëveshja e Punëve Ndërtimore të nënshkruar ndërmjet FKEE-së dhe Kompanisë së Ndërtimit.

Komuna do të transferojë kontributin e saj të bashkëfinancimit në llogarinë e caktuar të FKEE brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëfinancimit, e cila do të ndodhë para fillimit të zbatimit të projektit. Mosrespektimi i këtij kushti nga ana e Komunës, do të rezultojë me anulim të projektit.

4. Masat tipike të efijencës së energjisë që mund t'i zbatojë FKEE-ja

Për çdo NShB sociale të përzgjedhur, FKEE-ja do t'i identifikojë masat përkatëse të efijencës së energjisë që do të zbatohen duke u bazuar në analizën e ndërtesës, të dhënat e konsumit, potencialin për kursim të energjisë dhe nivelin e mirëqenies.

Më poshtë janë renditur masat tipike të efijencës së energjisë që mund të aplikohen në kuadër të Projektit:

- Mbështjellësi i ndërtesës (izolimi termik i mureve, bodrumeve, i nën-kulmit, përmirësime në hidroizolimimin ose termoizolimimin e çatave/kulm, riparimin/ndërrimin e dyerve të jashtme dhe dritareve, optimizimi i dritareve, etj.);
- Përmirësimi/ndërrimi i kaldajave/bojlerëve dhe sistemit të ngrohjes;
- Ndërrimi/zëvendësimi i lëndës djegëse/diversifikimi,
- Lidhja me sistemin e ngrohjes së qytetit;

- Përmirësimi/instalimi i sistemeve automatike dhe të kontrollit;
- Izolimi i tubave dhe pajisjeve;
- Pompat termike për ngrohje dhe ftohje;
- Ndiriçimi LED në ndertësë;
- Kontrolli automatik i sistemeve të ndiriçimit në ndertësë;
- Masa të tjera të këshilluara.

Megjithatë, masat e sakta të efijencës së energjisë do të përcaktohen vetëm pas përfundimit të auditimit të detajuar të energjisë dhe dizajnit të detajuar të NShB-ve sociale të përzgjedhura.

5. Përparësitë e projektit

Kjo është një mundësi e shkëlqyer për Komunën tuaj që ta përmirësojë efijencën e energjisë së ndërtesave tuaja dhe t'i përmirësojë kushtet e jetesës së qytetarëve (grupet sociale të pa favorizuara dhe të cenueshme) që banojnë në NShB-të sociale me një grant prej 90%, pa asnjë kontribut financiar të drejtpërdrejtë nga banorët e NShB-ve sociale të përzgjedhura. Prandaj, FKKEE-ja i inkurajon të gjitha komunat në Kosovë që ta paraqesin dhe dërgojnë shprehjen e interesimit të tyre duke e plotësuar formularin në Shtojcën 1 – Formularin e Aplikimit për këtë Thirrje.

6. Procedura e Aplikimit

Ju lutem paraqisni shprehjen tuaj të interesit duke përdorur Formularin e Aplikimit më poshtë nën Aneksin 1 së bashku me dokumentet mbështetëse të kërkuara sipas Tabelës 1, 2 dhe 3 të Formularit të Aplikimit.

Ju lutem të përdorni një aplikacion për një NShB sociale të propozuar. Në rastet kur Aplikuesi shpreh interes për të përfshirë më shumë se një NShB, ju duhet të plotësoni të njëjtin Formular Aplikimi veçmas për çdo NShB të propozuar dhe të dërgoni dokumentacionin siç kërkohet në Formularin e Aplikimit. Prandaj, ky Formular Aplikimi do të ofrohet në një format të modifikueshëm që të plotësohet lehtësisht nga Aplikuesi. Ju lutem të shkarkoni formularin e editueshem (të plotësueshëm) në formatin PDF, nga webfaqja e FKKEE.

Aplikimet duhet të dorëzohen vetëm në mënyrë elektronike në adresën: publiccalls@fkee-rks.net

Ju lutem vini re se Aplikimet do të zgjidhen mbi bazën “*kush vjen i pari, shërbehet i pari*” në varësi të plotësimit të kriterëve të përshtatshmërisë të treguara më sipër.

Për të siguruar transparencë në procesin e aplikimit bazuar në parimin “*kush vjen i pari, shërbehet i pari*”, ju lutemi vini re se një përgjigje automatike do të dërgohet për të konfirmuar marrjen e e-mailit tuaj. Megjithatë, duhet të theksohet se ky faktor nuk do të konsiderohet i vlefshëm nëse aplikacioni juaj nuk përmbushin kriteret e përshtatshmërisë dhe kërkesat e tjera të kësaj thirrjeje.

Nëse hasni ndonjë vështirësi gjatë paraqitjes së aplikacionit tuaj online, ju lutemi na kontaktoni duke përdorur detajet e mëposhtme të kontaktit: Email: info@fkee-rks.net ose telefon +383 (0) 38 223 777 (në çdo ditë punë nga ora 8:30-16:30).

Afati i aplikimit: deri më **17 prill, 2023**, fundi i ditës kalendarike.

SHTOJCA 1

FORMULARI I APLIKIMIT

Për: Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE)
Nga: [Emri i Komunës Aplikuese]
Tema: Thirrje Publike për Aplikime - Projekti Emergjent për Masat e Eficiencës së Energjisë së Ndërtesave Shumë-banesore (NShB) sociale në Pronësi të Komunave - Viti 2023
Data: ___ prill 2023

I/E nderuar,

Sipas Thirrjes suaj Publike të datës 7 Prill 2023, shprehim interesimin tonë për të aplikuar për investime në masat e eficiencës së energjisë në NShB-të sociale të Komunës dhe pajtohemi që investimet e tilla do të realizohen nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë, dhe bashkë financohen nga FKEE dhe Komuna jonë.

Me këtë ne kuptojmë se ju nuk keni obligim të aprovoni aplikimin/et tona dhe se procesi i përzgjedhjes sipas kësaj Thirrjeje Publike është subjekt i shqyrtimit paraprak dhe miratimit nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë.

Ju lutemi gjeni më poshtë ndërtesën e propozuar për t'u përfshirë në këtë projekt së bashku me informacionin e kërkuar të plotësuar në Tabelat 1, 2 dhe 3 dhe dokumentet e kërkuara mbështetëse.

Tabela 1. Të dhënat e përgjithshme të ndërtesës

A është ndërtesa e propozuar (ndërtesa shumë banesore sociale) në pronësi të Komunës? (Po/Jo) Nëse PO, luteni ta ofroni një dokument që e tregon pronësinë e Komunës mbi NShB-në sociale të propozuar p.sh. të dhënat kadastrale, fletën poseduese etj.	(Të plotësohet nga Aplikuesi/Komuna përkatëse)
Ju lutem të konfirmoni nëse ndërtesa është banueshme? (Po/Jo)	(Të plotësohet nga Aplikuesi/Komuna përkatëse)
Ju lutem të konfirmoni nëse ndërtesa e propozuar është e banuar nga familjet përkatëse? (Po/Jo) Nëse PO, të dëshmohet me faturë të energjisë elektrike /numri i matësit-njehsorit)	(Të plotësohet nga Aplikuesi/Komuna përkatëse)

Ju lutem konfirmoni se ndërtesa është e qëndrueshme dhe pa defekte në aspektin strukturor dhe nuk ju është nënshtruar rinovimit të plotë për eficiencë të energjisë në pesë (5) vitet e fundit. (Po/Jo)	(Të plotësohet nga Aplikuesi/Komuna përkatëse)
A planifikohet aktualisht që ndërtesa e propozuar të transformohet, të mbyllet, të ri-destinohet apo të privatizohet? (Po/Jo)	(Të plotësohet nga Aplikuesi/Komuna përkatëse)

Tabela 2. Të dhëna specifike të ndërtesës

Emri dhe të dhënat e kontaktit të administratorit të ndërtesës (<i>luteni të vini re se FKEE-ja mund të kontaktojë me përfaqësuesin e autorizuar nëse ka nevojë për sqarime për këtë aplikim</i>):	(Të plotësohet nga Aplikuesi/Komuna përkatëse)
Emri i ndërtesës/adresa/qyteti	(Të plotësohet nga Aplikuesi/Komuna përkatëse)
Lloji i ndërtesës	(Të plotësohet nga Aplikuesi/Komuna përkatëse)
Viti i ndërtimit të ndërtesës	(Të plotësohet nga Aplikuesi/Komuna përkatëse)
Sipërfaqja e ngrohur (m ²)	(Të plotësohet nga Aplikuesi/Komuna përkatëse)
Numri i përfituesve (Numri i familjeve dhe banorëve)	(Të plotësohet nga Aplikuesi/Komuna përkatëse)

Tabela 3. Disponueshmëria e buxhetit

A posedon Komuna Aplikuese buxhetin e nevojshëm në për të bashkë financuar MEE-in NShB-të e propozuara sociale për vitin 2023? (Po/Jo)	(Të plotësohet nga Aplikuesi/Komuna përkatëse)
Nëse PO, ju lutemi jepni dëshmi për disponueshmërinë e këtij buxheti duke dorëzuar numrin/kodin buxhetor të projektit bazuar në Ligjin aktual për ndarjet buxhetore.	
A zotohet Aplikuesi/Komuna për të siguruar mirëmbajtjen dhe qëndrueshmërinë e investimeve në MEE në NShB-të e zgjedhura sociale pas Periudhës së Përgjegjësisë së Defekteve? (Po/Jo)	(Të plotësohet nga Aplikuesi/Komuna përkatëse)

*Shënim për Aplikuesin/Komunën: Konfirmimi i disponueshmërisë së mjeteve/buxhetit është ekuivalent me “Deklarimin e disponueshmërisë së mjeteve” që përdoret në proceset e prokurimit publik.

Komentet e tjera relevante të plotësohen nga Aplikuesi/Komuna (nëse ka)

Me nënshkrimin dhe dorëzimin e Formularit të Aplikimit si dhe dokumenteve të nevojshme të kërkuara në Ftesë Publike, ne, të nënshkruarit më poshtë, si përfaqësues të autorizuar të Komunës së [emri i komunës] i kuptojmë dhe zotohemi për kushtet në vijim:

Të gjitha informatat e plotësuara në tabelat 1, 2 dhe 3 të Formularit të Aplikimit, përfshirë të gjithë dokumentacionin relevant që e kemi dorëzuar, janë të vërteta, të sakta, dhe të plota.

Ne e kuptojmë dhe pajtohemi që çfarëdo informate e pavërtetë ose lajthitëse që kemi paraqitur në këtë formular të aplikimit apo/dhe dokumentacionin shoqërues, do të rezultojë në refuzimin e aplikimit tonë nga ana e FKEE-së.

Nënshkruar nga:

[Emri, Mbiemri]

Kryetar i Komunës

Komuna e [_____]

Nënshkruar nga:

[Emri, Mbiemri]

Zyrtar për Energji /Koordinator i Projektit

Komuna e [_____]

Shënime tjera:

Ju lutem të shkarkoni nga webfaqja e FKEE formularin për aplikim në version të editueshem (të plotësueshëm) në [PDF](#).

Ju lutem pasi ky formular të plotësohet me kompjuter, të printohet dhe nënshkruhet në origjinal. I njëjti të skanohet me ngjyra dhe dërgohet në mënyrë elektronike së bashku me dokumentet tjera shoqëruese të kërkuara dhe udhëzuara në Thirrjen Publike për Aplikim.